

RUBRIKA I

E DREJTA KUSHTETUESE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Teza 8

I. Rrethoni alternativën e saktë

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet:

- për shkaqe të tillë si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore
- për shkaqe të tillë si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive
- për asnjë shkak dhe në asnjë rrethanë

2. Askush nuk mund t'i nënshtrohet dënitit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruar:

- përveç rastit kur akuzohet për krime kundër njerëzimit
- përveç rastit kur akuzohet për kryerjen e akteve terroriste
- në asnjë lloj rrethane apo situate

3. Ka fuqi më të lartë juridike në Shqipëri:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB-së
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike i OKB-së
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut

4. Presidenti i Republikës zgjidhet për:

- 5 vjet, pa të drejtë rizgjedhje
- 5 vjet, pa të drejtë rizgjedhje menjëherë pas mbarimit të mandatit
- 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë

5. Amendamenti kushtetues i miratuar nga Kuvendi i nënshtrohet referendumit kur kërkohet nga:

- Presidenti i Republikës
- Kryeministri
- Një e pesta e të gjithë anëtarëve të Kuvendit

6. Gjykata Kushtetuese mund të kryejë kontrollin e kushtetutshmërisë së një marrëveshje ndërkombëtare:

- Pas ratifikimit të saj në Kuvend
- Para ratifikimit të saj
- Pas botimit të marrëveshjes së ratifikuar në Fletoren Zyrtare



7. Për të rrëzuar dekretin e Presidentit të Republikës, që kthen ligjin për rishqyrtim, kërkohet jo më pak vota se:

- a. 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit
- b. shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit
- c. 2/3 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit

8. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit për Gjyqtar në Gjykatën e Lartë, të propozuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, humbet fuqinë kur kundër këtij dekreti votojnë:

- a. jo më pak se tri të pestat e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor
- b. shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor
- c. jo më pak se dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor

9. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zgjidhet nga:

- a. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Financave
- b. Presidenti, me propozim të Kryeministrit
- c. Kuvendi, me propozim të Presidentit të Republikës

10. Tre anëtarë/gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese zgjidhen nga:

- a. Këshilli i Lartë Gjyqësor
- b. Gjykata e Lartë
- c. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi



RUBRIKA II

E DREJTË ADMINISTRATIVE – E DREJTË PUNE

TEZA 10

Rrethoni alternativën e saktë:

11. Cili parim kufizon të drejtat themelore të individit për arsyen e mbrojtjes së interesit publik:

- a) parimi i përgjegjshmërisë,
- b) parimi i proporcionalitetit,
- c) parimi i paanësisë,
- d) parimi i mbrojtjes së sekretit shtetëror.

Rrethoni alternativën e saktë:

12. Organet kolegjiale:

- a) ndryshe nga organet monokratike, nuk mbështeten tek Kodi i Procedurave Administrative për vendimarrjet e tyre,
- b) mbështeten vetëm tek ligjet specifike, me të cilat janë krijuar në ushtrimin e detyrave të tyre,
- c) ndryshe nga organet individuale kanë vetëm një ligj bazë për organizimin dhe funksionimin e tyre, - ligjin mbi organet kolegjiale,
- d) asnjëra prej tyre.

Rrethoni alternativën e saktë:

13. Gjykata Kushtetuese:

- a) nuk kontrollon në asnjë rast aktet administrative individuale,
- b) shqyrton aktet administrative normative,
- c) nuk ka të drejtë të rishikojë kushtetutshmërinë e asnjë akti administrativ,
- d) asnjëra prej tyre.

Rrethoni alternativën e saktë:

14. Nuk përfshihen në përkufizimin e organit publik sipas Kodit të Procedurave Administrative:

- a) Gjykatat gjatë ushtrimit të veprimitarës së tyre gjyqësore
- b) Personat fizikë të cilëve u është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjeter, të parashikuar nga legislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike
- c) Entet publike në masën që kryejnë funksione administrative
- d) Organet e qeverisjes qendrore për aq sa kryejnë funksionet publike



Rrethoni alternativën e saktë:

15. Kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor, i cili ka dekluaruar të pavlefshëm një akt administrativ:

- a) akti nuk ka fuqi prapavepruese,
- b) akti ka fuqi prapavepruese,
- c) aktit mund t'i jepet fuqi prapavepruese,
- d) akti e merr fuqinë juridike, vetëm pasi vërtetohet një nga rastet e efektit të vonuar.

16. Rrethoni alternativën e saktë:

- a) Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet.
- b) Paditë për mosmarrëveshjet administrative, që kanë për objekt mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm, që rrjedhin nga sendet e paluajtshme, shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin në të cilin organi publik ka selinë e tij,
- c) Kur kompetenca tokësore nuk mund të përeaktohet në këtë mënyrë, atëherë kompetente është gjykata, në territorin e së cilës ka kryer veprimin organi publik i paditur.

Rrethoni alternativën e gabuar:

17. Gjykata Administrative e Apelit prish vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë dhe ia dërgon çështjen organit kompetent për rigjykim kur:

- a) gjykata administrative e shkallës së parë ka shkelur dispozitat mbi juridikcionin dhe kompetencën lëndore dhe funksionale;
- b) përbërja e trupit gjykues nuk ka qenë e rregullt apo vendimi ose procesverbali gjyqësor nuk është nënshkruar sipas ligjit;
- c) gjykata ka vendosur pushimin e çështjes në kundërshtim me ligjin;
- d) gjykata ka shkelur dispozitat e këtij ligji, lidhur me njofimet e palëve dhe akteve, edhe kur një shkelje e tillë nuk ka ndikuar në dhënen e vendimit;

E DREJTE PUNE

Rrethoni alternativën e saktë:

18. Në rastet e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi, nëse gruaja është në punë gjatë periudhës së shtatëzanisë, ose ëhstë kthyer në punë pas lindjes:

- a) i takon punëmarrëses të provojë që shkaku i pushimit nga puna ka qenë shtatëzania ose lindja e femijës;
- b) i takon punëdhënësit të provojë që shkaku i pushimit nga puna ka qenë shtatëzania ose lindja e femijës;
- c) të dyja palët kanë detyrimit të provojnë pretendimin e tyre.



Rrethoni alternativën e saktë:

19. Padia ndaj personave që banojnë në Republikën e Shqipërisë ngrihet:

- a) para gjykatës së vendbanimit të të paditurit;
- b) në vendin ku punëmarrësi kryen zakonisht punën e tij;
- c) asnjë nga alternativat
- d) të dyja alternativat “a” dhe “b”.

Rrethoni alternativën e saktë:

20. Punëdhënësi para fillimit të aktivitetit të sipërmarrjes, duhet të marrë leje nga Inspektori i Punës, për:

- a) vënien në punë dhe mjedisin e ndërmarrjes;
- b) administrimin e substancave të rrezikshme;
- c) masat mbrojtëse me karakter të përgjithshëm që do të zbatojë;
- d) higjenën e vendeve të punës.



RUBRIKA I
E DREJTË PENALE – PROCEDURË PENALE
TEZA 17

I. Rrethoni alternativën saktë:

E DREJTË PENALE

21. Masat edukuese mund të jepen nga gjykata:

- (a) Ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer një vepër penale;
- (b) Ndaj personave që e kanë kryer veprën penale në gjendje të dehur ose nën efektin e narkotikëve;
- (c) Ndaj personave që kanë bashkëpunuar më drejtësinë dhe janë përjashtuar nga dënim;
- (d) Ndaj të miturve që janë përjashtuar nga dënim;

22. Bashkimi formal i dënimive ekziston në rastin kur:

- (a) Një person ka kryer disa vepra penale për të cilat nuk është dhënë akoma vendimi;
- (b) Kur një person gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, kryen edhe një vepër tjetër penale;
- (c) Kur veprimet ose mosveprimet e personit, përbajnjë elementet e disa veprave penale;

23. Identifikoni shprehjen e saktë:

- (a) Element kryesor i veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” është mbajtja e tyre pa lejen e organeve kompetente shtetërore;
- (b) Element kryesor i veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” është që arma apo municionet të janë në gjendje të rregullt teknike, pavarësisht nëse ato realizojnë qitje apo jo;
- (c) Element kryesor i veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” është sasia e madhe dhe ardhja e një pasoje të rëndë;

24. Krimi i “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, kryhet edhe në formën e mbajtjes së narkotikëve:

- (a) Përveç kur rezulton e provuar se narkotikët janë mbajtur në doza të vogla dhe për përdorim vetjak;
- (b) Përveç kur rezulton se lënda narkotike është mbajtur për përdorim vetjak;
- (c) Përveç kur rezulton se lënda narkotike është prodhuar me qëllim për përdorim vetjak;

25. Element i domosdoshëm i anës objektive të krimit “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” është:

- (a) Ardhja e pasojës kriminale, përmes të gjitha formave të kryerjes së saj si: shitjes apo marrjes në çdo formë, shpërndarje, tregtimi, transportimi apo mbajtjes së lëndëve narkotike;
- (b) Kryerja e kësaj vepre penale, përmes të gjitha formave të kryerjes së saj si: shitja apo marrja në çdo formë, shpërndarja, tregimi, transportimi, mbajtja e lëndëve narkotike, në kundërshtim me ligjin, pa autorizim të organit kompetent;
- (c) Kryerja e kësaj vepre penale me dashje direkte dhe me qëllim përfimi material apo çdo përfitim tjetër;



PROCEDURË PENALE

26. Përgjimi i bisedimeve ose komunikimeve lejohet kur hetohet për një vepër penale të kryer me anën e mjeteve të telekomunikimit, në rastet kur:

- a) kur vepra kryhet me dashje,
- b) edhe në rastin e një vepre të kryer nga pakujdesia,
- c) nuk lejohet asnjëherë,
- d) në rastin b), por me autorizim të prokurorit.

27. Kompetenca tokësore përcaktohet në radhë të parë:

- a) nga vendbanimi i të pandehurit,
- b) nga vendi ku ardhur pasoja e veprës penale;
- c) nga vendi ku është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale,
- d) nga vendi ku ndodhet prokuroria që ka regjistruar e para procedimin penal.

28. Oficeri i policisë gjyqësore mund të kryejë veprime për kërkimin e autorit të veprës penale:

- a) vetëm kur autorizohet nga eprori i tij;
- b) vetëm kur autorizohet nga prokurori që drejton hetimet;
- c) vetëm kur autorizohet nga prokurori që drejton hetimet dhe, në raste të ngutshme, nga eprori i tij;
- d) në çdo rast konstatimi të një vepre penale që ndiqet kryesisht;

29. Cilësia e të pandehurit merr fund atëhere kur:

- a) jepet vendimi i dënimit në shkallën e parë;
- b) gjyqtari miraton urdhërin penal të dënimit;
- c) gjyqtari i seancës paraprake vendos dërgimin e çështjes në gjyc;
- d) vendimi i dënimit merr formën e prerë;

30. Lidhur me aktin e ekspertimit, është i vërtetë pohimi:

- a) eksperti zgjidhet detyrimisht vetëm nga personat e regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim;
- b) personi nën hetim nuk ka të drejtë të përjashtojë ekspertin e caktuar nga prokurori;
- c) ekspert i huaj mund të caktohet vetëm me anën e një letërporosie drejtar autoritetit gjyqësor të huaj;
- d) ekspertimi është i pavlefshëm në rastet kur nuk pranohen pyetjet e shtruara nga mbrojtja e të pandehurit.



RUBRIKA IV
PROCEDURË CIVILE DHE E DREJTË CIVILE

TEZA 6

PROCEDURË CIVILE

31. Rrethoni alternativën e gabuar:

- Kur Gjykata e Apelit konstaton se çështja nuk hyn në juridikcionin gjyqësor, prish vendimin dhe vendos vetë pushimin e gjykimit të çështjes;
- Gjykata e Apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim, kur gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat për juridikcionin;
- Gjykata e Apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim, kur gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat mbi kompetencën lëndore, funktionale, apo kompetencën tokësore ekskluzive;
- Gjykata e Apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim, kur ka shkelur dispozitat mbi kompetencën edhe kur konstaton se gjykata e shkallës së parë ka dhënë një vendim të drejtë dhe nuk ka kapërcyer kompetencën e gjykatës së cilës i takonte çështja.

32. Rrethoni alternativën e saktë:

- Pushimi i gjykimit vendoset kur i padituri, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, nëse paditësi nuk kërkon që gjykimi të zhillohet në mungesë;
- Pushimi i gjykimit vendoset vetëm kur i padituri, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore, nëse paditësi nuk kërkon që gjykimi të zhillohet në mungesë;
- Pushimi i gjykimit nuk mund të vendoset në asnjë rast për shkak të mungesës së të paditurit pa ndonjë shkak të arsyeshëm.

33 Rrethoni alternativën e saktë:

- Ndërhyrësi kryesor ndërhyr në një proces gjyqësor me kërkesë për t'u bashkuar me njérën nga palët në gjykim;
- Ndërhyrësi kryesor ndërhyr në një proces gjyqësor, vetëm duke ngritur padi kundër të dyja palëve në gjykim;
- Ndërhyrësi kryesor ndërhyr në një proces gjyqësor, duke ngritur padi kundër të dyja palëve në gjykim, ose njérës prej tyre.

34. Rrethoni alternativën e saktë:

- Punëdhënësi i debitorit të cilit i është njoftuar nga përmbaruesi sekuestrimi i pagës së debitorit, nuk ka detyrim të lajmërojë përmbaruesin në rast se më pas e pushon nga puna debitorin;
- Punëdhënësi i debitorit të cilit i është njoftuar nga përmbaruesi sekuestrimi i pagës së debitorit, ka detyrim të lajmërojë përmbaruesin në rast se më pas e pushon nga puna debitorin;
- Punëdhënësi i debitorit të cilit i është njoftuar nga përmbaruesi sekuestrimi i pagës së debitorit, ka detyrim që, në rast se përmbaruesi ia ka kërkuar, ta lajmërojë atë, në rast se më pas e pushon nga puna debitorin;
- Punëdhënësi i debitorit të cilit i është njoftuar nga përmbaruesi, sekuestrimi i pagës së debitorit, ka detyrim të lajmërojë përmbaruesin në rast se më pas e ka paralajmëruar debitorin për pushim nga puna.



35. Rrethoni alternativën e saktë:

- a. Vendimet e ndërmjetme në çdo rast mund të ndryshohen ose të revokohen nga gjykata që i ka shpallur;
- b. Vendimet e ndërmjetme nuk mund të revokohen apo ndryshohen nga gjykata që i ka dhënë, nëse ndaj tyre parashikohet ankim i veçantë;
- c. Vendimet e ndërmjetme mund të revokohen ose ndryshohen nga gjykata që i ka dhënë ato edhe nëse ato janë shpallur mbi bazën e një marrëveshjeje të palëve në rastet që ato vetë mund të disponojnë.

E DREJTË CIVILE

36. Rrethoni alternativën e gabuar:

- a) Shkaku i kontratës që vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik, ose kur kontrata bëhet mjet për të shmangur zbatimin e një norme quhet shkak i paligjshëm.
- b) Kontrata e pengut mund të bëhet me gojë.
- c) Kontrata e hipotekës duhet të regjistrohet.

37. Rrethoni alternativën e saktë:

- a) Në rast se detyrimi është i pjesëtueshëm, kreditori nuk mund të refuzojë kërkesën e debitorit për shlyerje pjesë-pjesë të detyrimit.
- b) Në rast se detyrimi është i pjesëtueshëm, debitori që nuk e shlyen dot të gjithë detyrimin mund ta shlyejë atë pjesë-pjesë vetëm me pëlqimin e kredititorit.
- c) Në rast se detyrimi është i pjesëtueshëm, debitori që nuk e shlyen dot të gjithë detyrimin mund ta shlyejë atë pjesë-pjesë.

38. Rrethoni alternativën e saktë:

- a) Kushti është pezullues kur të drejtat dhe detyrimet lindin po të ndodhë ngjarja.
- b) Kushti është pezullues kur të drejtat dhe detyrimet shuhën po të ndodhë ngjarja.
- c) Kushti është pezullues kur të drejtat dhe detyrimet nuk shuhën po të ndodhë ngjarja.

39. Rrethoni alternativën e saktë:

- a) I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç dhe personat që janë krejt të pazotë për të vepruar nuk përgjigjen për dëmin e shkaktuar.
- b) I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç dhe personat që janë krejt të pazotë për të vepruar përgjigjen për dëmin e shkaktuar vetëm kur veprojnë me faj të rëndë.
- c) I mituri që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç dhe personat që janë krejt të pazotë për të vepruar përgjigjen për dëmin e shkaktuar vetëm kur veprojnë me pakujdesi të rëndë.

40. Rrethoni alternativën e saktë:

- a) Prezumohet se ka qenë zënë në kohën e çeljes së trashëgimisë, ai që ka lindur brenda 320 ditëve nga vdekja e trashëgimlënësit.
- b) Prezumohet se ka qenë zënë në kohën e çeljes së trashëgimisë, ai që ka lindur brenda 300 ditëve nga vdekja e trashëgimlënësit.
- c) Prezumohet se ka qenë zënë në kohën e çeljes së trashëgimisë, ai që ka lindur brenda 350 ditëve nga vdekja e trashëgimlënësit.



RUBRIKA V

E DREJTA FAMILJARE DHE E DREJTA TREGTARE

TEZA 10

E DREJTA FAMILJARE

41. Rrethoni alternativën e saktë: Është e vertete se dispozitat e Kodit të Familjes për regjimet pasurore:
- Mund të zbatohen me analogji edhe për bashkëjetuesit;
 - Mund të zbatohen plotësisht vetëm nëse parashikohen nga bashkëjetuesit në kontratën notoriale;
 - Nuk mund të zbatohen;
 - Mund të zbatohen edhe për bashkëjetuesit nëse kanë fëmijë të lindur nga bashkëjetesa.
42. Rrethoni alternativën e saktë: legjitimohet që të kërkojë në gjykatë lidhjen e martesës pa shpallje.
- Secili nga bashkëshortët e ardhshëm
 - Prokurori i vendit ku lidhet martesa
 - Çdo përsone i interesuar
 - Të afërmit pa kufizime.
43. Rrethoni alternativën e saktë: *Veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës:*
- Do të bëjë pjesë në bashkësinë ligjore në çdo rast
 - Nuk do të bëjë pjesë në bashkësi nëse në kapitalin themeltar kontribuon vetëm njëri bashkëshort
 - Do të bëjë pjesë në bashkësi nëse kontibutet e investuara në kapital janë fituar gjatë martesës
 - Do të jetë pasuri vetjake nëse të ardhurat e investuara janë fituar para martesës
44. Rrethoni alternativën e saktë: Në vazhdimin e një procesi gjyqësor të filluar, në rastin e pavlefshmërisë për shkak lajthitjeje, legjitimohen:
- Trashëgimtarët e paditësit
 - Prokurori
 - Kushdo që ka interes të ligjshëm
 - Asnjë më sipër
45. Rrethoni alternativën e saktë: Vendosja e fëmijës në përkujdesje alternative rekomandohet duke ndjekur këtë radhë:
- Pranë një të afërmë të fëmijës; pranë një familjeje kujdestare; në një institucion rezidencial të përkujdesjes, kur nuk është e mundur asnjë nga alternativat e mësipërme;
 - Pranë një familjeje kujdestare; pranë një të afërmë të fëmijës; në një institucion rezidencial të përkujdesjes, kur nuk është e mundur asnjë nga alternativat e mësipërme.
 - Në një institucion rezidencial të përkujdesjes, pranë një të afërmë të fëmijës; pranë një familjeje kujdestare;
 - Nuk ka një rregull të detyrueshëm të radhëve



E DREJTA TREGTARE

I. Rrethoni alternativën e saktë:

46. Në një shoqëri kolektive likuidimi kryhet nga një likuidues i emëruar nga:

- a. të gjithë ortakët në mënyrë unanime;
- b. me vendim të shumicës së thjeshtë të ortakëve;
- c. me vendim të shumicës së cilësuar të ortakëve;
- d. asnjë prej tyre.

47. Një SHPK themelohet nga:

- a. vetëm persona fizik;
- b. vetëm persona juridik;
- c. persona juridik dhe fizik;
- d. asnjë prej tyre.

48. Në një SHPK, kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, të drejtat e tyre ushtrohen:

- a. nga një përfaqësues i përbashkët;
- b. nga një përfaqësues i secilit prej tyre;
- c. nga të secili prej ortakëve;
- d. asnjë prej tyre.

49. Asambleja e Përgjithshme në një SHPK mund të emërojë si administrator të shoqërisë:

- a. vetëm një person fizik;
- b. vetëm një person juridik;
- c. një ose më shumë persona fizik e juridik;
- d. një ose më shumë persona fizik.

50. Kontributi i ortakëve në një shoqëri kolektive mund të jetë:

- a. vetëm në para;
- b. në para dhe letra me vlerë të tregtueshme;
- c. në para, në natyrë (pasuri të luajtshme, të paluajtshme dhe shërbime)
- d. asnjë prej tyre.



RUBRIKA VI
E DREJTA E BE-SË
E DREJTA NDËRKOMBËTARE PUBLIKE
TEZA 10

I. Rrethoni alternativën e saktë

E DREJTA E BE-SË

51. Institucioni me karakter mbikombëtar në BE është:

- a. Komisioni
- b. Këshilli i Ministrave
- c. Parlamenti European
- d. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

52. Efekti i drejtpërdrejtë i zbatimit të *acquis* sipas GJED nënkupton që:

- a. Shtetet nuk mund të nxjerrin masa të mëtejshme zbatimi pas daljes së një akti ligjor të Bashkimit
- b. Shtetet nuk mund të nxjerrin masa të brendshme zbatimi me të njëjtën përbajtje për t'i dhënë efekt një akti ligjor të Bashkimit
- c. Nene të caktuara të Traktatit të BE mund t'i japid të drejta subjektive personave, përmbrojtjen e të cilavet mund t'u drejtohen gjykatave kombëtare
- d. E drejta e BE ka karakter erga omnes.

53. Parlamenti European është:

- a. Bashkëlegjislator me Këshillin e Ministrave
- b. Bashkëlegjislator me Këshillin European
- c. Bashkëlegjislator me Komitetin e Rajoneve
- d. Bashkëlegjislator me Komitetin Ekonomik dhe Social.

54. Bashkimi European:

- a) nuk mund të jetë palë në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, pasi palë mund të jenë vetëm shtetet, jo organizatat
- b) është palë në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
- c) ka vendosur përfundimisht që nuk do të jetë palë në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
- d) nuk është ende palë në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, për shkak të Opinionit të Gjykatës së Drejtësisë.

55. Shtetet Anëtare mund të kufizojnë të drejtat e lëvizjes së lirë për:

- a. Shkaqe ekonomike
- b. Shkaqe mjedisore
- c. Shkak të politikës publike, sigurisë publike ose shëndetit publik
- d. Shkaqe arsimore.



E DREJTË NDËRKOMBËTARE PUBLIKE

56. Vija bazë normale formohet prej:

- a) Bashkimit të pikave më të dala të tokës në det
- b) Vijës normale të bregdetit
- c) Vijës së zbatimës më të madhe.

57. Autoriteti Ndërkombëtar i Fundit të Detit mbikëqyr:

- a) Shfrytëzimin e Shëlfit Kontinental
- b) Shfrytëzimin e Zonës
- c) Shfrytëzimin e Zonës Ekonomike Ekskluzive.

58. Klasat (gradat) e konsuve janë:

- a) 1) Konsuj profesionistë 2) Konsuj karriere
- b) 1) Konsull i Përgjithshëm 2) Ministër Fuqisë 3) Konsull 4) Agjent konsullor
- c) 1) Konsull i Përgjithshëm 2) Konsull 3) Nënëkonsull 4) Agjent konsullor.

59. Në çështjen e Arit Monetar Shqiptar, Komisioni Tripalësh vendosi:

- a) Mbi përkatesinë e arit duhet të vendosë një arbitër ndërkombëtar
- b) Ari i përkiste Italisë, pasi Italia zotëronte shumicën e aksioneve të Bankës së Shqipërisë
- c) Ari i përkiste Shqipërisë, pasi ishte pjesë e thesarit të Bankës së Shqipërisë.

60. Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB:

- a. Janë të detyrueshme në çdo rast
- b. Janë të detyrueshme vetëm kur Këshilli i Sigurimit ndërhyn përmbrrojtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare në kuadër të Kapitullit VII të Kartës së OKB
- c. Janë të detyrueshme edhe në rastet kur Këshilli u rekomandon palëve në mosmarrëveshje që çështjen ta zgjidhin me mjete paqësore.



RUBRIKA VII
HISTORIA E SË DREJTËS NË SHQIPËRI

Teza 6

Rrethoni alternativën e saktë:

61. Pas shkëputjes nga Perandoria Bizantine, klasa feudale arbëreshe:

- a) Krijoi një të drejtë të re
- b) Pranoi të drejtën bizantine
- c) Pranoi të drejtën bizantine, por jo plotësisht, duke u larguar gradualisht nga parimet e saj

62. Gjatë mesjetës, në Arbëri, ‘paktet e vasalitetit’:

- a) Ishin veprime juridike të njëanëshme
- b) Dëshmonin për një regjim juridik që ndryshonte nga ai Lindjes
- c) Ishin veprime juridike që krijonin të drejta vetëm për një palë dhe vetëm detyrime për palën tjetër

63. Statutet e Shkodrës përmbanin norma juridike që rregullonin:

- a) Vetëm për ndërtimet dhe mbajtjen e pastërtisë
- b) Ndërtimet dhe mbajtjen e pastërtisë, trashëgiminë ligjore dhe testamentare, ushtrimin e magjisë
- c) Vetëm për trashëgiminë ligjore dhe testamentare

64. Përgjatë historisë së Lidhjes së Lezhës (periudha e Skënderbeut):

- a) Subjekt i marrëdhënieve ndërkombëtare ka qenë gjithnjë Lidhja
- b) Vetëm në një rast Lidhja ka qenë subjekt i marrëdhënieve ndërkombëtare
- c) Lidhja nuk ka qenë në asnjë rast subjekt i marrëdhënieve ndërkombëtare

65. E drejta zakonore shqiptare:

- a) Mbeti e pandryshuar, edhe me ndryshimin e kushteve historike
- b) Nuk përbënte një sistem të plotë juridik, edhe pse rregullonte jetën e njeriut nga lindja në vdekje
- c) Karakterizohet nga uniteti dhe diversiteti

66. Sipas të drejtës zakonore shqiptare:

- a) Njerëzit ishin të barabartë në të drejta dhe detyrime përpala Kanunit dhe ai i trajtonte ata njësoj
- b) Besa zbatohet vetëm për një grup njerëzish të një rangu shoqëror të lartë
- c) Parashikohej dënim i me rrahje dhe fyerja e fajtorit



67. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë:

- a) Statuti i Lushnjës konsiderohet si Kushtetuta e parë e shtetit shqiptar, e miratuar nga një organ kombëtar
- b) Kongresi i Lushnjës shpalli Durrësin kryeqytet
- c) Këshilli Kombëtar – organ i krijuar nga Kongresi i Lushnjës – do të ushtronë funksionet e qeverisë

68. Sistemi politik i pranuar nga Statuti i Zgjeruar i Lushnjës:

- a) Ishte Republikë parlamentare
- b) Ishte Monarki parlamentare
- c) Nuk bazohej në parimin e ndarjes së pushteteve

69. Statuti Themeltar i Mbretërisë parashikonte që:

- a) Pushtetet nuk ishin të ndara në: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor
- b) Pushteti legjislativ ushtrohej kolektivisht (prej mbretit dhe parlamentit)
- c) Deputetët nuk gëzonin imunitet parlamentar

70. Mbreti, sipas Statutit Themeltar të Mbretërisë:

- a) nuk ishte komandant i përgjithshëm i forcave të armatosura
- b) lidhte traktate miqësie dhe aleanca, pa njofuar parlamentin
- c) lidhte traktate miqësie dhe aleanca, por njoftonte parlamentin



RUBRIKA VIII
GJUHA SHQIPE
TEZA 13

71. Cila nga fjalitë e mëposhtme është fjalë e urtë?

- a) Ia merr pula bukën nga goja.
- b) Buka që thyhet nuk ngitet më.
- c) Sikur i ka ngrënë gomari bukën.
- d) E kishte ngrënë turpin me bukë.

72. Përeaktoni numrin e gabimeve në tekstin e mëposhtëm:

“Gjithkush ka të drejtë të mbrojë Interesat Morale dhe Materiale, që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare dhe Artistike, autor i të cilave është ai vetë.”

- a) 7;
- b) 6;
- c) 5;
- d) 4.

73. Cili nga përemrat e mëposhtëm tregon frymor?

- a) Asgjë;
- b) Diçka;
- c) Ndokush;
- d) Gjithçka.

74. Në cilën nga fjalitë e mëposhtme kryefjala shprehet me grup emëror?

- a) Në atë vrapim mori pjesë edhe shoku i tij i klasës.
- b) Atë vjeshtë, shirat po vononin të binin.
- c) Në atë çast erdhi me vrap rojtari.
- d) Gjatë pushimit studentët lexonin leksionet.

75. Në vargjet: “se të qante, kur të qeshnin
se të yeshte, kur të zhveshnenin”,
fjalët e nënvízuara janë:

- a) Sinonime;
- b) Antonime;
- c) Homonime;
- d) Epitete.



76. Në fjalinë: “*Në sallë bënte shumë nxeh të*”, folja është:

- a) Vetore;
- b) Pavetore;
- c) Njëvetore;
- d) Gjysmëndihmëse.

77. Në cilin rast fjala “për” është parafjalë?

- a) Shkoi pér studime;
- b) Shkoi pér tē studiuar;
- c) Pér tē dalë mirë bëri kurse;
- d) La shkollën pér tē punuar.

78. Në cilin rast fjala “nga” është ndajfolje?

- a) Mbaj vesh andej nga vjen zëri.
- b) Nga shkove?
- c) Erdha nga shtëpia, por s’të gjeta.
- d) Mësova shumë nga motra.

79. Çfarë tregon fjalia: “*Hajde, dil e mos bëj naze!*”:

- a) Këshillë;
- b) Propozim;
- c) Urdhër;
- d) Lutje.

80. Kryefjala në fjalinë: “*Të njohurit e përshëndetnin kur i kalonin pranë.*” shprehet:

- a) Me mbiemër;
- b) Me grup emëror;
- c) Me emër;
- d) Me pjesore.



RUBRIKA IX

Teza 7

I. Rrethoni alternativën e saktë:

81. Cili është numri që mungon në këtë seri numrash: ?, 22, 16, 11, 7, 4.

- a) 33;
 b) 31;
 c) 29;
 d) 28.

82. Sa kuti me dimisone $1\text{m} \times 1\text{m} \times 50\text{ cm}$ mund t  paketohen n  nj  kontejner me dimisone $8\text{x } 6\text{x } 6\text{ m}^3$?

- a) 144;
 b) 288;
 c) 315;
 d) 576.

83. Një tren hyn në një tunel që është 2.5 km i gjatë dhe udhëton me 80 km/orë. Gjatësia e trenit është 500 m. Sa kohë i duhet të gjithë gjatësisë së trenit të kalojë nëpër tunel nga momenti që fillon futet deri në daljen e fundit të trenit?

- a) 2 minuta e 15 sekonda;
 - b) 2 minuta e 30 sekonda;
 - c) 3 minuta;
 - d) 2 minuta e 25 sekonda.

84. Cili numér, nëse ka, mungon në këtë seri numrash?

5433544335543354335543354433554335443355433544335543354433554

- a) 3;
 - b) 4;
 - c) 5;
 - d) Asnje.

85. Sa zona kohore të ndryshme ka përreth planetit Tokë?

- a) 4;
 - b) 6;
 - c) 12;
 - d) 24.

86. Cili prej numrave nuk i përket kësaj serie?

62195126219512612195126219512

- a) 1;
 - b) 6;
 - c) 2;
 - d) 9.



87. Antoni, Xhoni dhe Rodi u përpoqën të gjithë të merrnin shumë artikuj në karrocën e tyre në supermarket. Kur u ndërgjegjësuan se ishin shumë, vendosën të hiqnin disa artikuj sesa të dilnin nga radha. Personi që hoqi bukët nuk ishte personi me 14 artikuj, që kishte më pak sesa personi që zgjodhi të hiqte disa shishe. Sikur Antoni të kishte më shumë artikuj se sa personi që hoqi konservat, i cili nuk ishte Rodi, atëherë kush kishte 13 dhe 15 artikuj, dhe çfarë hoqën nga artikujt e tyre ata?

- a) Antoni 14, konserva; Rodi 13, bukë; Xhoni 15, shishe.
- b) Antoni 13, bukë; Rodi 15, shishe; Xhoni 14, konserva.
- c) Xhoni 14, konserva; Antoni 13, bukë; Rodi 15, shishe.
- d) Rodi 13, bukë; Antoni 15, shishe; Xhoni 14, konserva.

88. Çfarë konkluzioni mund të nxirret nga teksti origjinal pa pasur asnjë informacion tjetër shtesë ?

Avionët reaktivë lëvizin me shtyrje.

- a) Shumica e avionëve reaktivë janë avionë lehtësish të manovrueshëm dhe të hollë.
- b) Avioni reaktiv fluturon në drejtëm të kundërt të erës.
- c) Gazrat që shtyhen shkaktojnë një reaksiون që lejon aeroplakin të ecë përpara.
- d) Shumica e avionëve reaktivë kanë katër motorë.
- e) Shtyra reaktive bën që avionët reaktivë të fluturojnë më shpejt se të tjerët.

89. Unë jam 48 vjeç dhe gruaja ime është 39 vjeç. Sa vjeç isha unë, kur isha sa dyfishi i moshës së saj?

- a) ---10
- b) ---18
- c) ---15
- d) ---11

90. Tri fjalët e vendosura me poshte si dhe fjala e katërt që ne na duhet të zgjedhim midis propozimeve a, b, c dhe d janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Cila eshte fjala e katert ?

QARTËSI vs IDE - --DRITË vs ?

- a) KUJDES
- b) PERCEPTIM
- c) ASOCIACION
- d) MENDIME



RUBRIKA X

ETIKA PROFESIONALE

TEZA 5

I. Rrethoni alternativën e saktë:

91. Prokurori, kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, shkarkohet nga:

- a) Prokurori i Përgjithshëm;
- b) Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- c) Ministri i Drejtësisë.

92. Këshilltari për Etikën gjyqësore caktohet nga:

- a. Gjykata e Lartë;
- b. Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- c. Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

93. Cili nga pohimet e mëposhtme, në lidhje me kodin e etikës së një profesioni është më i saktë?

- a. Një kod etike synon që të gjithë anëtarët e një profesioni të veprojnë me etikë gjatë kohës së ushtrimit të profesionit;
- b. Një kod etike komunikon parimet dhe sjelljen e pritur nga shoqëria ndaj anëtarëve të një profesioni;
- c. Të gjitha sa më sipër

94. Magjistratët e gjykatës së Apelit, X, Y dhe Z me cilësinë e gjyqtarit të çështjes, kanë patur komunikime telefonike, me shtetasin V, palë ndërgjygjëse në një çështje pronësie që po gjykohet prej tyre. V-ja i ka ftuar gjyqtarët X, Y dhe Z për të udhëtar së bashku në Itali dhe Spanjë. Ku biletat e udhëtimit me avion, biletat e ndeshjeve sportive ndërkombëtare të futbollit si dhe faturat e qëndrimit në hotel, do të paguhen nga V. Gjithçka u realizua sipas propozimit të palës ndërgjygjëse. Cilin nga parimet e etikës gjyqësore kanë cenuar tri gjyqtarët e gjykatës së Apelit:

- a. Parimin e pavarësisë;
- b. Parimin e paanësisë;
- c. Parimin e integritetit.

95. A duhet avokati të arrijë, një marrëveshje personalisht ose nëpërmjet një sekseri me klientin e tij, për të siguruar pasuri ose të drejta të tjera, të cilat janë subjekt i çështjes:

- a. Po;
- b. Jo.



96. Kodi i Etikës Gjyqësore, si rregull zbatohet nga:

- a. Të gjithë gjyqtarët antarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- b. Të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë;
- c. Të gjithë gjyqtarët e sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

97. A duhet prokurori për të “blinduar” akuzën, të mbështesë në mënyrë të papërshtatshme interesat e një pale, në dëm të palës tjetër:

- a. Po;
- b. Jo.

98. Është e saktë shprehja: Një avokat nuk do të ketë ka pasoja të natyrës etike, nëse ka vepruar në drejtimin e një avokati tjetër.

- a. E vërtetë;
- b. E pavërtetë

99. Gjyqtari, është caktuar për shqyrtimin e një çështjeje me objekt “zgjidhje martese” dhe ka nisur procedurat e divorcit. Gjatë procedurës gjyqtari ka marrë një mesazh në celular nga një deputet i Kuvendit, ku thotë që po iu shkruaj në emër të një votuesi që ka çështjen e zgjidhjes së martesës tek ju. Deputeti kërkon që gjyqtari ta përrshpejtojë çështjen e divorcit, si dhe votuesi i tij të marrë “pjesën e drejtë” në ndarjen e pronës bashkëshortore. Cilin nga parimet e etikës gjyqësore po cenon ndërhyrja e deputetit të Kuvendit:

- a. Parimin e integritetit;
- b. Parimin e pavarësisë;
- c. Parimin e paanësisë.

100. Prokurori i një qyteti të vogël si ka blerë një autoveturë të markës Hyundai. Pas një defekti të vogël e dërgon veturën për riparim në një servis të qytetit. Pas eliminimit të defektit, mekaniku duke e ditur se është prokuror nuk pranon që t'ia marrë paratë. Pas një kohe, prokurori ka nevojë prapë ta dërgojë veturën tek mekaniku. Në qytet është i vetmi servis që merret me rregullimin e defekteve të autoveturave të markës Hyundai. Si të veprojë prokurori në këtë situatë:

- a. Të shkojë prapë tek i njëjtë Servis;
- b. Të kërkojë ndonjë servis të ngjashëm në qytetet përreth, ku të rregullojë veturën e tij.

